



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2022:204129  
Datë: 14.05.2024  
Numri i dokumentit: 05679794

**C-IV-22-0329**

*Parashtruesja e kërkesës*

**R C** nga Prishtina, tani me vendbanim në Vranjë, , e përfaqësuar nga ana e avokatëve të Projektit për ndihmë juridike falas, Graçanicë

*Kundër*

*Pala kundërshtare*

**Agjencia Kosovare e Privatizimit – AKP (NSH “Fabrika Amortizatorëve” në likuidim), Rr. “Agim Ramadani” nr. 23, Prishtinë**

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), gjyqtari Gazmend Sylaj, me 14 maj 2024, lëshon këtë:

**AKTGJYKIM**

- 1. Ankesa e ankueses refuzohet si e pabazuar.**
- 2. VËRTETOHET vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRN047-0646 datë 24 tetor 2014.**
- 3. Secila palë i bartë shpenzimet e veta.**

**Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me 19 dhjetor 2013, ankuesja parashtror kërkesë për rishikimin e vendimit të Autoritetit të Likuidimit (AL), sipas ankueses, PRN047-0646 datë 24 tetor 2013 (në tekstin e mëposhtëm Vendimi), me të cilin i ishte refuzuar kërkesa për kompensimin të pagave për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës (*otpremnine*), për periudhë të pacaktuar, në shumë prej 8,128.00 (tetë një dy tetë ) Euro, ndaj NSH “Fabrika Amortizatorëve” (në likuidim).

Ankuesja nuk ka parashtruar kopjen e Vendimit të AL.

Ankuesja pohon se ishte punëtore e evidentuar e NSH gjer në qershor 1999. Pas kësaj periudhe pohon se faktikisht i është ndërprerë marrëdhënia e punës si rezultat i diskriminimit të punëtorëve të nacionalitetit Serb. Ankuesja, mbi diskriminimin i referohet Vendimit të DHPGJS.

Ankuesja tutje pohon se si pasojë e situatës së krijuar shoqëroro-politike, në qershor të vitit 1999, është detyruar të lëshoj Prishtinën e njëkohësisht edhe vendin e saj të punës. Vendin e punës është detyruar ta lëshoj për shkak të situatës së sigurisë e jo me vullnetin e saj të lirë.

Ankuesja konsideron si të bazuar kërkesën e saj mbi pagat dhe kontributeve të sigurimit pensional, invalidor dhe shëndetësor dhe atë për periudhën dhe shumën e kërkuar përfshirë edhe kamatën ligjore.

Ankuesja përfundimisht konsideron se afatet e parashkrimit duhet të rrjedhin nga data kur ka pasur të drejtën të parashtoj kërkesën e saj mbi përmbushjen e detyrimeve.

AKP me 18 dhjetor 2017 parashtoj përgjigjen.

AKP kundërshtoj ankesën si të pabazuar. AKP pohoi se e mbështet në tërësi vendimin e AL mbi bazën e arsytimit të refuzimit të kërkesës si vendim i drejtë dhe i ligjshëm. Sipas AKP, ankuesja nuk ka parashtruar argumentet e saj ligjore në kuptim të dispozitave ligjore të Shtojcës së Ligjit për AKP. AKP tutje pohon se ankuesja nuk i ka dëshmuar kushtet ligjore të parapara sipas nenit 40.1.6.2, të Shtojcës së Ligjit për AKP, që kërkesa e saj të jetë e pranueshme. AKP përfundimisht pohon se kërkesa e ankueses konsiderohet e parashkruar sipas dispozitave ligjore të Ligjit për punën e bashkuar- LPB ligji i aplikueshëm sipas Rregullores së UNMIK-ut 1999/24. AKP i referohet Vendimeve të DHPGJS. Nga gjitha arsyet, AKP propozoj që kërkesa për rishikim të hedhet si e papranueshme ose refuzohet si e pabazuar dhe vendimi i AL të vërtetohet.

Përgjigjes i është bashkangjitur:

- Kopja e Vendimit të AL- PRN047-0646 datë 24 tetor 2013, i cili është objekt shqyrtimi sipas kërkesës për rishikim.

Përgjigja ju dorëzua ankueses me 27 shkurt 2018.

Ankuesja nuk parashtoj përgjigje.

Me 1 shkurt 2021, gjykata lëshoj një vërejtje për ankuesen mbi pagesën e taksës gjyqësore. Me të njëjtën vërejtje ankuesja u informua se nëse taksat nuk paguhen brenda periudhës së caktuar prej 15 ditësh, ankesa do të konsiderohet e tërhequr.

Pas tentimit të dytë vërejtja e lartë cekur ju dorëzua ankueses me 24 mars 2021.

Gjykata me Aktvendimin C-IV-13-3862 datë 29 korrik 2021 kërkesën e ankueses për rishikim-ankesën e konsideroj të tërhequr për shkak të mos – pagesës së taksës gjyqësore.

Kolegji i Apelit i DHPGJS (KA), me Aktvendimin e saj AC-I-21-0607 datë 29 shtator 2022, aprovoj ankesën e ankueses dhe anuloi Aktvendimin e gjykatës datë 29 korrik 2021.

KA në arsyetimin e vendimit, theksoj që gjykata duhet që paraprakisht të vendosë sipas kërkesës së ankueses mbi lirimin e pagesës së taksës gjyqësore.

Me Aktvendimin e gjykatës, datë 25 prill 2024, gjykata shqyrtoj kërkesën e ankueses mbi lirimin e taksave gjyqësore ashtu që kërkesa është aprovuar.

## Arsyvetimi ligjor

Kërkesa për rishikim - ankesa konsiderohet e pabazuar.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit për DHPGJS (ligji nr.06/L-086) në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Në rastin konkret bazuar sipas nenit 31 paragrafi 4 dhe 5 dhe nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS është obligim i palës, në këtë rast ankueses, që në parashtresat e saj me shkrim, ankesën, të paraqesë një pasqyrë të hollësishme të fakteve dhe arsyetimit ligjor mbi të cilin vendos qëndrimin dhe argumentimin e saj. Në rastin kur pala pohon, në këtë rast ankuesja, të ekzistojë një fakt, ajo palë është e obliguar të paraqesë prova, fizike dhe/ose dëshmuese, për mbështetjen e atij pohimi.

Nga dispozita e cekur si më lartë, është obligim i ankueses që të dëshmoj detyrimet ndaj saj, mbi mos pagesën e të ardhurave personale.

Sipas Vendimit të AL, kërkesa e ankueses ishte kompensimi i pagave për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës ( *otpremnine*), për periudhë të pacaktuar.

Dispozitat ligjore lidhur me pagat e papaguara si dhe kompensimit, si rezultat i shitjes apo privatizimit apo edhe likuidimit nga ana e AKP, duke u bazuar në nenin 40 të SHTOJCËS së Ligjit për AKP mbi prioritet e kërkesave dhe interesave, paragrafi 1.6 pika 1.6.1 parashihen kërkesat për pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguar deri në datën e vendimit nga Gjykata apo Agjencia për fillimin e procedurave të likuidimit, të kufizuar në tri paga mujore bruto për person dhe pika 1.6.2.kërkesat për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të sjella nga punonjësit të cilat janë pushuar nga puna si rrjedhojë e Vendimit për Likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga Agjencia sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP-në.

Nga dispozitat e lartë cekura, mund të konkludohet se, punëtori/ja gëzon të drejtën në paga respektivisht dëmshpërblim nëse:

- a. pagat e punonjësit, në këtë rast ankuesit, nuk janë paguar;
- b. Kontrata mbi punën i është ndërprerë para afatit të përfundimit, të saj;
- c. Pushimi nga puna ka ardhur si pasojë i Vendimit të AL; dhe
- d. Ndonjë veprim nga Agjencia, lidhur me administrimin e ndërmarrjes, shitjes, likuidimit etj.

Tutje sipas nenit 40 mbi prioritetin e kërkesave dhe interesave, paragrafi 1.7 parashihet përmbushja e kërkesave: *“kërkesat e pasiguruara, përfshirë Kërkesat për paga që nuk janë subjekt i trajtimit me prioritet më të lartë”*.

Në interpretim të dispozitave të cekura si më lartë, në njërën anë, si dhe pohimeve të ankueses se pranë NSH ka punuar gjer në qershor të vitit 1999, në anën tjetër, gjykata gjeti se asnjëra nga kushtet ligjore për të kërkuar të drejtën në paga nuk janë plotësuar.

Vendimi i DHPGJS lidhur me të drejtën e në pjesëmarrje nga 20% nga privatizimi i NSH, paraqet një kategori tjetër ligjore, e kërkesave, dhe cila rregullohet sipas dispozitave ligjore të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 me plotësime dhe ndryshime.

Nga gjitha arsyet si më lartë ankuesja nuk ka dëshmuar të drejtën e saj mbi pagat ashtu siç edhe parashihet sipas nenit 40 të SHTOJCËS së Ligjit për AKP, paragrafi 1.6 pika 1.6.1 si dhe 1.7 por edhe nuk ka dëshmuar ndonjë obligim tjetër ashtu siç parashihet sipas nenit 31 paragrafi 4 dhe 5 dhe nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS

Nga gjitha arsyet u vendos si në dispozitiv.

### **Shpenzimet Gjyqësore**

Ankuesja është liruar nga pagesa e taksave gjyqësore.

Në pajtim me nenin 62 të Ligjit për DHPGJS, secila palë i bartë shpenzimet e veta.

Andaj u vendos si në dispozitiv.

### **Këshillë juridike**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të DHPGJS brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për DHPGJS.

---

Gazmend Sylaj, Gjyqtar



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

Numri i lëndës: 2022:204129  
Datë: 14.05.2024  
Numri i dokumentit: 05679794

**C-IV-20-0329**

*Podnosilac zahteva*

**R C** iz Prištine, sada sa prebivalištem u Vranji, zastupljena od strane advokata Projekta za besplatnu pravnu pomoć, , Gračanica

*Protivu*

*Suprotna*

*stranka*

**Kosovske Agencija za Prvatzaciju – (KAP) (DP "Fabrika Amortizera" u likvidaciji), Ul. "Dritan Hoxha" br. 55, Lakrishte, Priština**

Posebna komora Vrhovnog suda Kosova za pitanja vezanim za Kosovsku agenciju za Privatizaciju (PKVSK), sudija Gazmend Sylaj, dana 14 maja 2024 godine. donosi sledeću:

**PRESUDU**

- 4. Žalba žaljlje odbija se kao neosnovana.**
- 5. POTVRĐUJE se rešenje Organa za Likvidaciju PRN047-0646 od 24 Oktobra 2014 godine.**
- 6. Ne određuju se sudski troškovi.**

**Činjenične i proceduralne okolnosti**

Dana 19 Decembra 2013 godine, pri PKVSK, žaljlja je podnela zahtev o preispitivanju Rešenja Organa za Likvidaciju (OL), po žaljlji, PRN047-0646 od 24 Oktobra 2013 godine ( u daljem tekstu Rešenje), kojim je obijen zahtev o nadoknadi ličnih dohotka zbog prekida radnog odnosa (*otpremnine*), za neodređeni period, u iznosu od 8,128.00 (osam jedan osam) Euro, nad DP "Fabrika Amortizera".

Žaljilja nije podnela kopiju Rešenja OL.

Žaljilja je navela da je bila evidentnerina radnica DP do Juna 1999 godine. Posle ovog perioda nave da mu se faktički prekinula radni onos kao posledica diskriminacije radnika Srpske nacionalnosti. Žaljilja se referisala Odluci PKVSK.

Žaljilja je dalje navela da kao posledica nastale društvene-političke situacije, u Junu 1999 godine, primorana da napusti Prištinu i samim tim i svoje radno mesto. Radno mesto bila primorana da napusti zbog bezbednosne situacije a ne svojom voljom.

Žaljlja smatra kao osnovanim svoj zahtev o platama i doprinosa penzijskog invalidskog i zdrastvenog siguranja i to za zatraženi period i sumu uključujući zakonsku kamatu.

Žaljlja konačno smatra da se rokovi zastarevanja treba početi od datuma kada je imalo pravo podneti njen zahtev o ispunjenju obaveza.

KAP je dana 18 Decembra 2017 godine podnela odgovor.

KAP se usprotivila na žalbu žaljlje smatrajući kao neosnovanom. KAP navela da podržava u celosti rešenje OL na osnovu obrazloženja odbijanja zahteva kao pravednu i zakonsku odluku. Po KAP-u, žaljlja nije podnela svoje zakonske dokaze u smislu zakonskih odredaba Aneksa Zakona o KAP-u. KAP je alje navela da žaljlja nije dokazivala zakonske uslove koja su predviđena po članu 40.1.6.2, Aneksa Zakona o KAP-u, da bi njen zahtev bio prihvatljiv. KAP konačno je navela da zahtev žaljlje smatra se zastareo po zakonskim odredabama Zakona o Udruženom Radu- ZUR, zakom koji se primenjuje po UNMIK-ovoj Uredbi 1999/24. KAP se referisao Odlukama PKVSK. Iz svih razloga, KAP je predlagala da se zahtev o preispitivanju odbacuje kao neprihvatljivim ilii odbija kao neosnovanim i da se rešenje OL potvrđuje.

Sa odgovorom je priloženo:

- Kopija Rešenja OL – PRN047-0646 od 24 Oktobra 2013 godine, predmet razmatranja po zahtevu o preispitivanju.

Odgovor je dostavljeno žaljlji dana 27 Februara 2018 godine.

Žaljlja nije podnela odgovor.

Dana 1 Februara 2021 godine sud je izdao opomenu, za žaljlji o naplati sudske takse. Sa istom opomenom žaljlja je informisana da ako se sudske takse ne isplate u određenom roku od 15 dana, žalba smatraće se povučenom.

Gore navedena opomena posle drugog pokušaja je dostavljeno žaljlji dana 24 marta 2021 godine.

Sud je svojim Rešenjem C-IV-13-3862 od 29 Jula 2021 zahtev žaljlje o preispitivanju-žalbu samtrala povučenim zbog toga što nije platika sudkse takse.

Apelaciono Veće PKVSK (AP), je Rešenjem AC-I-21-0607 od 29 Septembra 2022 godine, usvojila žalbu žaljlje i ukinula Rešenje suda od 29 Jula 2021 godine.

AV u obrazloženu svog rešenja, navela da sud treba prvo razmotriti i odlučiti po zahtevu žaljlje o oslobođenju plaćanja sudkse takse.

Po Rešenju suda, od 25 Aprila 2024 godine, sud je razmotrio zahtev žaljlje o oslobođenju plaćanja sudkse takse tako što je zahtev usvojen.

### **Pravno obrazloženje**

Zahtev o preispitivanju - žalba smatra se neosnovanim.

Na osnovu člana 76.3 Zakona o PKVSK (zakon br.06/L-086 ) u vezi člana 399 Zakona o parničnom postupku, sud nalazi da relevantne činjenice predmeta su neosporne i ovu Presudu izdaje bez zakazanja ročišta.

U konretnom slučaju po članu 31 tačka 4 i 5 i člana 35 tačka 2.4 Zakona o PKVSK, obaveza je stanke, u ovom slučaju žaljilje, da u svojim pismenim podnescima, žalbi, podnesese iscrpne činjenice i pravno obrazloženje na kojima temelje svoje stavove i argumente. U slučaju kada stranka navodi, u ovom slučaju žalilac, postojanje neke činjenice, ta stranka je dužna da predloži dokaze, fizičke i/ili podneske na osnovu kojih dokazuju svoje navode.

Iz gore navedene odredbe, je obaveza žaljilje do dokazuje obavezu nad njom, o neisplaćenom ličnom dohotku.

Po Rešenju OL, zahtev žaljilje je bio nadoknada plata zbog prekida radnog odnosa (*otpremnine*), za neodređeni period.

Zakonske odrebe u vezi neisplaćenog ličnog dohotka kao i naknade, kao posledica privatizacije ili i likvidacije od strane KAP-a, osnivajući se na član 40 ANEKSA Zakona o KAP-u, o prioritetima zahteva i interesa, paragraf 1.6 tačka 1.6.1 predviđeno potraživanja za plate zaposlenih koji nisu isplaćeni do datuma odluke Suda ili Agencije da se započne postupak likvidacije, ograničena na tri meseca bruto plate po licu i tačka 1.6.2. potraživanja za zakonom propisanu otpremninu prijavljena od strane radnika koji su postali višak zbog Odluke o likvidaciji preduzeća, ili u vezi sa tim, radnje preduzete od strane Agencije na osnovu člana 6.1 ili 6.2 Zakona o KAP-u.

Od gore navedenih odredaba, može se konstatovati da radnik/ca uživa pravo na dohotke odnosno nadonkadu ako:

- a. plate zaposlenih, u ovom slučaju žalioaca, koje nisu isplaćene;
- b. Ugovor o radu je prekinut prije isteka njenog roka;
- c. Radni odnos je prekinut kao posledica Odluke OL; i
- d. Neke druge radnje od strane Agencije, u vezi administracije preduzeća, prodaje, likuidacije itd.

Dalje po članu 40 o prioritetima potraživanja i interesa, tačka 1.7 predviđja se ispunjavanje potraživanja: “*neobezbeđena potraživanja, uključujući potraživanja za plate koja nisu predmet višeg prioriteta*”.

Interpretacijom gore navedenih odredaba, sa jedne strane, kao i navodima žaljilje da je pri DP radila do Juna meseca 1999 godine, sa druge strane, sud smatra da nijedan od zakonskih uslova o zahtevu prava o platama nije ispunjen.

Odluka PKVSK u vezi njegovog prava učešća na 20% od privatizicaje DP, predviđa jednu drugu kategoriju, zahteva, koja se regulišu po zakonskim odredbava UNMIK-ove Uredbe 2003/13 sa izmenama i dopunama.

Iz svih gore navedenih razloga žaljilja nije dokazivala njeno pravo na dohotke kao što je predviđeno po članu 40 paragraf 1.6 tačka 1.6.1 kao i 1.7, ANEKSA Zakona o KAP-ut ali i nije dokazivala neke ostale obaveza kao što je predviđeno po članu 31 tačka 4 i 5 i člana 35 tačka 2.4 Zakona o PKVSK.

### **Sudske takse**

Žaljlja je oslobođena od plaćanja sudkse takse.  
U smislu člana 62 Zakona o PKVS, svaka stranka snosi svoje troškove.

Stoga je odlučeno kao u izreci.

### **Pravni lek**

Protiv ove presude može se podneti pismena žalba Apelacionom veću PKVS u roku od 15 dana od dana prijema ove presude. Žalba se mora podneti u skladu sa članom 9 stav 6 Zakona o PKVS.

(potpisano)  
Gazmend Sylaj, Sudija